V E N D I M
Nr.598, datë 20.12.1994

PËR NRYSHIMIN E TARIFAVE TË TRANSPORTIT TË UDHËTARËVE

Me propozimin e Ministrisë së Financave dhe të Ministrisë së Industrisë, Transporteve dhe Tregtisë, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

1.Tarifat e transportit të udhëtarëve, të caktuara në pikën 1 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.16, datë 24.1.1994 "Për ndryshimin e tarifave të transportit të udhëtarëve dhe të shërbimeve të postave e telekomunikacioneve", ndryshohen si vijon:

a) Tarifat e transportit qytetar të udhëtarëve në linjat me largësi deri në 9 km, por brenda periferisë së qytetit, caktohen 7 lekë për një vajtje ose kthim, 160 lekë për një biletë pajtimi mujor dhe 450 lekë për atë tremujor.

Për nxënësit dhe studentët bileta e pajtimit mujor caktohet 80 lekë dhe ajo e pajtimit tremujor 220 lekë.

b) Tarifat e transportit hekurudhor të udhëtarëve rriten mesatarisht 20 për qind.

c) Tarifat e transportit ndërqytetor automobilistik të udhëtarëve dhe ato ujore (liqenore) rriten mesatarisht 15 për qind.

2. Ngarkohen Ministria e Industrisë, Transporteve dhe Tregtisë dhe Ministria e Financave të përcaktojnë me udhëzim të veçantë çmimet e reja të biletave të transportit hekurudhor e ato ndërqytetor, automobilistik dhe ujor, të udhëtarëve, si kufij maksimal.

Ky vendim hyn në fuqi më 1 janar 1995.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi